

Më
Dana 06 - 09 - 20 18

P.nr.2934/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDACTED] me vendbanim në Rr. [REDACTED], Komuna e Shtimes, [REDACTED] me vendbanim në Rr. [REDACTED], Komuna Shtime dhe [REDACTED] me vendbanim në Rr. [REDACTED], Komuna Shtimë, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës: PP/II.nr.1305-1/17 dt.22.11.2017, të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 30.05.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja, si dhe të pandehurve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] me datë 30.05.2018, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 14.06.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion vozitës në fabrikën "Minexit", e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetase i Republikës së Kosovës.

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën e mesme, me profesion montues pompash, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

Me datën 03.06.2017, rreth ores 00:40 në Fshatin Godanc, Komuna Shtime, të pandehurit me qëllim përdorimi, pa autorizim kanë poseduar narkotikë, ashtu që me rastin e ndalimit dhe kontrollimit të veturës nga Policia, na të cilën ishin të pandehurit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të pandehurit [REDAKTUAR] ishte gjetur një sasi e substancës narkotike e llojit Marihuanë, me peshë 3.90gram, kurse gjatë kontrollit të veturës nënë ulësen e përparme të pasagjerit të pandehurve [REDAKTUAR] së bashku me të miturin [REDAKTUAR], iu është gjetur një qese najlloni substancë narkotike e llojit [REDAKTUAR] me peshë 55.50,ku pas ekzaminimit nga Agjenciae Kosovës për Forenzikë, ka rezultuar se është Marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol, me peshë gjithsejt 59,40 gram, e cila sasi pas identifikimit nga policia është sekuestruar.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7, 17,41,42,46,49,50,51,52,73, nenit 275 par. 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPPRK-së, e

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarin [REDAKTUAR] me burgimi prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 2 /dy/ viteve nga data plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit), dhe

Dënim me gjobë në shumën prej 400 € /katërqind euro/, të cilëve u mundësohet pagesa me këste mujore në afatin kohor prej dy muajve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

— Të akuzuarit [REDAKTUAR] me burgimi prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 2 /dy/ viteve nga data plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale (koha e verifikimit), dhe

Dënim me gjobë në shumën prej 400 € /katërqind euro/, të cilëve u mundësohet pagesa me këste mujore në afatin kohor prej dy muajve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 25 Euro /njëzet e pesë/ secili veç e veç, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë..

Detyrohen të akuzuarit që për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, secili veç e veç, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/IL.nr.1305-1/17 dt.22.11.2017 ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurit të shpallen fajtores dhe t'iu shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Pas leximit të aktakuzës Gjykata konstaton se i akuzuari [REDAKTUAR], sa i përket vërtetimit të identitetit të tij u vërtetua në bazë të letërnjoftimit të tij se i akuzuari është i lindur më 24.09.1999 dhe në bazë të kësaj u vërtetua se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i mitur ende pa i mbushur 18 vjet, prandaj konform dispozitave të nenit 36 të KPRK-së gjykata vendosi që të veçohet procedura dhe rasti të procedohet në departamentin për të mitur.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 30.05.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: i akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, shpreh keqardhje edhe është i penduar thellë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i premtom gjykatës që në të ardhmen do të kryej vepra të tilla penale dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë. I akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është e vetëdijshme për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, shpreh keqardhje dhe është i penduar thellë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i premtom gjykatës që në të ardhmen do të kryej vepra të tilla penale dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë.

Prokurorja e Shtetit Mimoza Syla duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ti shpall fajtor dhe të iu shqipton dënimin e paraparë me ligj.

Me që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës dhe atë: vërtetimi mbi konfiskimin e substancave i dt.03.06.2017, raporti i ekspertimit për forenzik me nr.AKF/2017-2521/2017-2264 i dt.24.10.2017, fotografitë dhe raporti i oficerit i dt.03.06.2017 si dhe deklaratat e të pandehurve.

Me qenë se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar kanë pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se kanë qenë të dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale, janë të gjendjes së dobët ekonomike, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarve shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarve.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Pergjithshem-Divizioni Penal,
P.nr.2934/17 datë 14.06.2018.

Zyrtare ligjore,

Ganimete Avdiu

Gjyqtari,

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.